



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0216

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D. Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale, duke vendosur sipas ankesës së OE “MESE PHARM SH.P.K.”, kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “31 Furnizim me barna për SHPMPPF” me numër të prokurimit 616-25-1846-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”, më 16/05/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “MESE PHARM” SH.P.K. me nr. 2025/0216, e datës 02/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “31 Furnizim me barna për SHPMPPF”, me numër të prokurimit 616-25-1846-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”.
2. Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “31 Furnizim me barna për SHPMPPF”, me numër të prokurimit 616-25-1846-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”. AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit, ne njoftimin për kontratë dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.03.2025, “KOMUNA E PRISHTINËS” , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “31 Furnizim me barna për SHPMPPF” me nr.prokurimi: 616-25-1846-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 20,011.95 €.

Me 27.03.2025, OE “MESE PHARM SH.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “MESE PHARM SH.P.K.” me nr. 2025/0216 lidhur me aktivitetin “31 Furnizim me barna për SHPMPPF” me numër të prokurimit 616-25-1846-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MESE PHARM SH.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.13.03.2025, kurse hapja e ofertave është parashikuar të bëhet me dt. 02.04.2025. Ne kemi analizuar dosjen e tenderit dhe specifikat teknike të këtij aktiviteti të prokurimit dhe pas analizës që kemi bërë, kemi vërejtur se autoriteti kontraktues ka përgatitur dosjen e tenderit në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, për faktin se janë vendosur disa kërkesa diskriminuese/favorizuese, të cilat do të sqarojmë më poshtë: Fillimisht ju sqarojmë se ne me dt.24.03.2025 kemi parashtruar kërkesë për sqarim të dosjes së tenderit, mirëpo nuk kemi pranuar ndonjë përgjigje, prandaj kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me qëllim që të marrim përgjigje në pretendimet tona ankimore. 4 1. Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme a) Një menaxher projekti me profesion farmacist me 5 vite përvojë pune; b) Një Teknik I farmacisë me 5 vite përvojë pune. a) Për

menaxherin kërkohet CV , Diplomë Universitare (Fakulteti i mjekësisë-dega farmaci), Licenca e farmacistit, Kontrata dhe CV e Nënshkruar nga vetë menaxheri. b) Teknik të farmacisë së paku diploma e shkolles së mesme kontrata dhe licenca Kjo kërkesë është shumë kufizuese kur kemi parasysh se në këtë aktivitet të prokurimit kemi të bëjmë me furnizim dhe vlera totale e furnizimit është 20,011.95-euro për 12 muaj e cila realizohet e ndare ne pjese ne baza mujore. Në procedurat me vlera të tilla këto kërkesa konsiderojmë se janë jo në harmoni me qëllimin e prokurimit sepse është e panevojshme të ketë edhe farmacist e edhe teknik të farmacisë me 5 vite përvojë pune në këtë tender, sepse nuk kemi te bëjmë me ofrimin e shërbimeve specifike shëndetësore por kemi te bëjmë me furnizim me barna, ku Agjencioni i Barnave nuk kërkon 5 vite përvojë pune për të lëshuar Licensen për qarkullim me shumicë të barnave, prandaj kërkojmë që të largohet si kërkesë stafi i kërkuar me 5 vite përvojë pune. Kjo kërkesë nuk mund të interpretohet ndryshe përveç se një kriter i vendosur në mënyrë të paarsyeshme, i cili favorizon disa kompani të caktuara dhe kufizon pjesëmarrjen e kompanive tjera të interesuara për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit. Kërkesat e kontestuarra më lartë bien ndesh me parimet e transparencës dhe barazisë sipas nenit 7 të LPP-së. 2. Gjithashtu tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: Operatori ekonomik duhet te ofrojë Certifikata a) 9001-2015 b) ISO 13485 2016 c) ISO 14001 2015 Kopja e Certifikatës ISO 9001-2015, 13485-2016 dhe ISO 14001 2015 valide. Certifikata 13485:2016 ka të bëjë me sistemin e menaxhimit te cilësisë për prodhimin e pajisjeve mjekësore, e jo për barna. Certifikata 14001:2015 ka të bëjë me standardet ndërkombëtare për sistemin e menaxhimit mjedisor. Certifikata 9001:2015 ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të cilësisë për organizatat e ndryshme. Këto certifikata nuk kanë të bëjnë fare me këtë aktivitet të prokurimit, ku titulli tregon qe është: “31 Furnizim me barna për SHPMPPF”, prandaj kërkojmë që të largohen nga kërkesat e dosje së tenderit si të panevojshme. Këto certifikata vetëm favorizojnë kompani të caktuar ndërsa në realitet nuk kanë asnjë rëndësi apo impakt në këtë tender. Certifikatat e lartcekura nuk ndikojnë në cilësinë e furnizimit dhe vetëm favorizojnë kompani të caktuara, duke kufizuar konkurrencën dhe duke e bërë procesin e prokurimit më pak transparent dhe gjithëpërfshirës, andaj të njëjtat duhet të largohen në tërësi nga dosja e tenderit. 3. Tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu është specifikuar kërkesa si në vijim: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas 5 tabelës ne Aneksin 7 te DT. a) Së paku dy automjete (Pikap-KOMBI) për bartjen e mallit. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim. Në këtë tender me vlerë 20,011.95 euro të kërkohen këto pajisje/mjete konsiderojmë se është plotësisht e pa arsyeshme dhe e panevojshme sepse në këtë rast kemi të bëjmë me furnizime të vogla ne baza mujore, që secili OE mund ti kryej edhe me nje makine të thjeshtë, prandaj kërkojmë që të largohet kërkesa për mjete sepse nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij tenderi. Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e lartcekura, kërkojmë që kërkesa për posedimin e mjeteve të përmendura më lartë të largohet nga dosja e tenderit, pasi që e njëjta nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij prokurimi dhe vetëm kufizon konkurrencën në mënyrë të paarsyeshme. Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim

të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.27.03.2025 mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje, edhe pse nuk ka kaluar afati tre ditë pune për nxjerrje të vendimit, mirëpo për shkak se afati i fundit për ofertim është dt.02.04.2025, ne jemi të detyruar të parashetrojmë ankesë në OSHP. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”. Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk janë marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”. Kërkesa që u kundërshtua më lartë, është shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyll dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu kjo kërkesë bie në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, ku shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”. 6 Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca, prandaj duhet ndryshuar/larguar kërkesat e lartcekura që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik). Pra, në vend se të merret parasysh edhe zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinj, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit. Pra është kufizuar konkurrenca. Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së qëllimi i LPP-së, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “MESE PHARM SH.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 27 i LPP-së Neni 69 i LPP-së Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr: VENDIM të APROVOHET, e bazuar ankesa e OE

MESE PHARM SH.P. K dhe te NDRYSHOHEN kërkesat, që u çekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet çekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin përcaktimeve nga njësia kërkuese.

Lidhur me pretendimin e parë - së pari duhet çekur se ky aktivitet ka të bëjë me furnizim me barna. Kërkesa më minimale që mund të kërkohet për një projekt të tillë është tekniku i farmacisë dhe menaxheri i kontratës me profesion farmacist me min. 5 vite përvojë të punës. Pikërisht për shkak të faktit që kemi të bëjmë me furnizim me barna, është e domosdoshme që menaxheri i projektit të jetë farmacist me përvojë si dhe të ekzistoj së paku një teknik i farmacisë me përvojë të mjaftueshme.

Lidhur me pretendimin e dytë - çertifikatat ISO janë kërkuar nga AK në përputhje të plotë me LPP (shih nenin 69,70, et.al. të LPP). Këto çertifikata të kërkuara sipas DT, secila prej tyre veçmas dhe të gjitha së bashku, janë absolutisht të domosdoshme për të garantuar standardin e domosdoshëm të cilësisë që nevojitet për të realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet nga ky aktivitet i prokurimit. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e tretë - duhet çekur se parashtruesi nuk e konteston kërkesën si të tillë dhe aq më pak nuk prezanton argumente sipas të cilave kërkesa nuk do të ishte në përputhje me ndonjë dispozitë të LPP. Rrjedhimisht nuk është kontestuese se kërkesa për pajisje është e nevojshme në fakt e domosdoshme dhe në përputhje të plotë me qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Po ashtu kërkesa është formuluar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 08.04.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0216/2025, ndërsa me datë 18.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0216 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit, ne njoftimin për

kontratë dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, AK nuk ka dhen përgjigje dhe OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “MESE PHARM SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0216 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor 1.

Sipas pretendimi ankimor nr. 1 OE ankues pretendon si në vijim:

Në dosje të tenderit është kërkesa si në vijim:

Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme a) Një menaxher projekti me profesion farmacist me 5 vite përvojë pune; b) Një Teknik i farmacisë me 5 vite përvojë pune.

a) Për menaxherin kërkohet CV , Diplomë Universitare (Fakulteti i mjekësisë-dega farmaci), Licenca e farmacistit, Kontrata dhe CV e Nënshkruar nga vetë menaxheri.

b) Teknik të farmacisë së paku diploma e shkolles së mesme kontrata dhe licenca.

Sipas OE ankues Kjo kërkesë është shumë kufizuese kur kemi parasysh se në këtë aktivitet të prokurimit kemi të bëjmë me furnizim dhe vlera totale e furnizimit është 20,011.95-euro për 12 muaj e cila realizohet e ndarë në pjesë në baza mujore.

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoritetet Kontraktues gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit sipas nenit 69 të LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, saktësisht paragrafi 1 , thotë:

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkeje, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen.

Bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit ku AK-KK Prishtinë ka kërkuar ne lidhje me këtë pikë një menaxher te kontratës me profesion farmacist dhe nje teknik te farmacisë eksperti shqyrtues sqaron se një kërkesë e tillë është e lidhur direkt me aktivitetin e prokurimit per furnizim me barna andaj si e tillë nuk është jashtë qëllimit te aktivitetit te prokurimit dhe mendojmë qe janë ne harmoni me nenin 25.17 dhe 25.18 te Rregullores nr 1 per Prokurim Publik, citat neni 25.17 “Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Sipas përshkrimit te mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr.1 është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2.

Sipas pretenimi ankimor nr. 2 OE ankues pretendon si ne vijim:

Gjithashtu tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: Operatori ekonomik duhet te ofrojë Certifikata:

a) 9001-2015

b) ISO 13485 2016

c) ISO 14001 2015, Kopja e Certifikatës ISO 9001-2015, 13485-2016 dhe ISO 14001 2015 valide. Certifikata 13485:2016 ka të bëjë me sistemin e menaxhimit te cilësisë për prodhimin e pajisjeve mjekësore, e jo për barna.

Certifikata 14001:2015 ka të bëjë me standardet ndërkombëtare për sistemin e menaxhimit mjedisor. Certifikata 9001:2015 ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të cilësisë për organizatat e ndryshme.

Këto certifikata nuk kanë të bëjnë fare me këtë aktivitet të prokurimit, ku titulli tregon qe është: “31 Furnizim me barna për SHPMPP”, prandaj kërkojmë që të largohen nga kërkesat e dosje së tenderit si të panevojshme.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit Neni 70 te LPP-se Standardet për Sigurimin e Cilësisë, autoriteti kontraktues mund te kërkoj standarde te caktuara mbi sigurimin e cilesisë.

Standardi ISO 9001:2015, standard i përgjithshëm mbi menaxhimin e cilësisë, andaj mendojm pavarësisht zhvillimit te veprimtarisë mund te kërkohet sipas nenit 70 te LPP-së.

ISO 13485: 2016, Standard i sistemit te menaxhimit te cilësisë per pajisjet mjeksore, mendojmë qe duke u bazuar ne furnizimet e kërkuara furnizim me barna ky standard nuk është në harmoni me nenin 25.17 te Rregullores per Prokurim Publik sepse nuk është proporcional me objektin e kontratës duke marrë per bazë natyrën e furnizimeve dhe vleren e furnizimeve. Një kërkesë e e këtij standardi mendojm qe mund te kërkohet per prodhuesit e pajisjeve ne raste te caktuara dhe jo për operatorin ekonomik ofertues (furnizuesin) sepse standardi ISO 13485: 2016, lidhet me

prodhimin e pajisjeve.

Certifikata 14001:2015 ka të bëjë me standardet ndërkombëtare për sistemin e menaxhimit mjedisor, mendojmë që duke u bazuar në furnizimet e kërkuara furnizim me barna ky standard nuk është në harmoni me nenin 25.17 të Rregullores për Prokurim Publik sepse nuk është proporcional me objektin e kontratës duke marrë për bazë natyrën e furnizimeve dhe vlerën e furnizimeve.

Sipas përshkrimit të mësipërm konstatojmë se pretendimi ankimor nr.2 është i pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3.

Sipas pretendimit ankimor nr. 3 OE ankues pretendon si në vijim:

Tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu është specifikuar kërkesa si në vijim: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilizimet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas 5 tabelës në Aneksin 7 të DT.

a) Së paku dy automjete (Pikap-KOMBI) për bartjen e mallit. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen.

Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

Eksperti shqyrtues sqaron se një kërkesë e tillë e kërkuar në dosje të tenderit është në harmoni me qëllimin e aktivitetit të prokurimit sepse një furnizim i tillë i barnave duhet të bëhet me automjetet përkatëse. Po ashtu AK-KK Prishtinë në këtë rast ka mundur edhe marrjen në shfrytëzim të automjeteve të tilla duke dëshmuar me marrëveshjen për shfrytëzim dhe në këtë mënyrë mendojmë që ky kriter është në harmoni me Rregulloren nr 001/2022 për Prokurim Publik, saktësisht nën 25.17 “Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Sipas përshkrimit të mësipërm konstatojmë se pretendimi ankimor nr. 3 është i pa bazuar.

Nga përshkrimi i mësipërm i pretendimeve ankimore, kërkesave të dosjes, ankesës së operatorit ekonomik ankues, nën 6 dhe 7 të LPP-së konstatojmë se ankesa e operatorit ekonomik është pjesërisht e bazuar sipas përshkrimit të bërë tek pretendimi ankimor nr 2, andaj rekomandojmë që të bëhen korrigjimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues MESE PHARM SH.P.K është pjesërisht e BAZUAR, sipas përshkrimit tek pretendimi ankimor nr 2

Të bëhen korrigjimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-së lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “31 Furnizim me barna për SHPMPPF” me nr. të prokurimit: 616-25-1846-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar, lidhur me çertifikata standardet për sigurimin e cilësisë (Certifikatat ISO), AK mund të kërkojë në një aktivitet të prokurimit sikurse parashihet në nenin 70 të LPP-së e të cilat kanë lidhshmëri me fushveprimin , me aktivitetin sikurse ky aktivitet për furnizim me barna .

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “31 Furnizim me barna për SHPMPPF” me nr. të prokurimit: 616-25-1846-1-2-1, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit, ne njoftimin për kontratë dhe të zgjasë afatin për ofertim sikurse kërkohet sipas dispozitave ligjore të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 1,7 dhe 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - MESE PHARM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: